

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, në datën 12 / 04 / 2019, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, nga dhe midis Palëve të mëposhtme:

Teatri i Kukullave, me adresë në Rruga Çamëria, Tiranë (më tej referuar si "**Ofruesi i Shërbimit**")

DHE

Tirana East Gate Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Qendra Tregtare TEG, Rruga Nationale Tiranë – Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K82231001H, përfaqësuar nga administrator, Znj. Milena Gjoni, lindur në Mat, më 22.04.1988, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 032201041, (më tej referuar si (me tej referuar si "**Përfituesi**")

MEQËNËSE:


- Përfituesi dëshiron dhe është i interesuar të lidhë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi sipas parashikimeve këtu e më poshtë, objekti i së cilës do të përfshijë kryerjen e shërbimeve të parashikuara më poshtë në këtë Marrëveshje nga Ofruesi i Shërbimit.
- Ofruesi i Shërbimit dëshiron të kryejë në favor të Përfituesit, shërbimet e poshtë-përcaktuara sipas Marrëveshjes.
- Ofruesi i Shërbimit shpreh vullnetin e tij të mirë për të kryer dhe ndërmarrë kryerjen e shërbimeve në përputhje me këtë Marrëveshje duke garantuar një përmbushje profesionale dhe të kualifikuar të objektit të saj;
- Përfituesi shpreh vullnetin e saj të mirë dhe pranon shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimit, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara këtu e më poshtë.

SA MË SIPËR, DUKE MARRË NË KONSIDERA TË BESIMIN E NDËRSJELL TË DHE MARRËVESHJEN E ARRITUR, PALËT KONTRAKTUESE, DUKE PRANUAR DETYRIMIN LIGJOR QË RRJEDH PREJ SAJ, BIEN DAKORD MBI TERMAT DHE KUSHTET VIJUESE:

Neni 1. Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Termat e përfshirë në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimet e mëposhtme dhe do të interpretohen në përputhje me rrethanat përkatëse, përveç kur Palët kanë rënë dakord ndryshe në lidhje me to:

- '**Palët**' nënkupton Përfituesin dhe Ofruesin e Shërbimit, përfshirë vartësit, agjentët ose punonjësit;
- '**Marrëveshje Bashkëpunimi**' nënkupton këtë marrëveshje sipas përcaktimeve të mëposhtme (më tej referuar si '**Marrëveshja**');;
- '**Data e Fillimit**', nënkupton datën e parë të fillimit të efekteve të kësaj Marrëveshje (më tej referuar si '**Data e fillimit**');;



- **'Shërbimet Bazë'** nënkuptojnë shërbime si më poshtë të percaktuara (më poshtë referuar si **"Shërbimet Bazë"**);

Neni 2. Objekti i Marrëveshjes

- 2.1 Përfituesi cakton Ofruesin e Shërbimit që të ofrojë dhe kryejë në emër dhe për llogari të saj, për 3 (tre) muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, shfaqje të ndryshme për fëmijë, çdo të shtunë ose diele, por dhe ditë jave nëse palët bien dakord, deri në orën 18:00 në ambientet e Qendrës Tregtare "Tirana East Gate", në adresën Rruga Nacionale Tiranë – Elbasan, Qendra Tregtare TEG, Farkë, Lundër, Tiranë. (referuar bashkarisht si **"Shërbimet Bazë"**).
- 2.2 Ofruesi i Shërbimit garanton përmbushjen e Shërbimeve të percaktuara në pikat më sipër, në përputhje me afatet dhe termat e kësaj Marrëveshje .

Neni 3. Tarifa e Shërbimit dhe Mënyra e Pagesë

- 3.1 Përfituesi do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve, për tre muajt e kohëzgjatjes së Marrëveshjes, vlerën totale prej **250.000 Lekë (dyqind e pesëdhjetë mijë lekë)**. Kjo pagesë do të kryhet me këste, çdo muaj pas ofrimit të shërbimit. Në rast të përfundimit të marrëdhënieve kontraktuale para afatit të caktuar nga Palët në këtë Marrëveshje, Përfituesi do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve pjesën përkatëse të pagesës të llogaritur për Shërbimet e kryera deri në datën e zgjidhjes së Marrëveshjes.
- 3.2 Çmimi total që do paguajë Përfituesi në rast se kjo Marrëveshje rinovohet për tre herë të tjera rresht (pa ndërpreje) sipas nenit 6.1 të kësaj Marrëveshje (pra, në rast se plotësohet periudha një vjeçare e bashkëpunimit) do të jetë 700.000 ALL (shtatëqind mijë lekë), dhe pas plotësimit të kësaj shume në tre mujorin e katërt të rinovimit të marrëveshjes, Përfituesi nuk detyrohet të bëjë asnjë pagesë tjetër në favor të Ofruesit të Shërbimit.
- 3.3 Tarifa e Shërbimit do të paguhet me transfertë bankare nga Përfituesi në llogarinë bankare të Ofruesit të Shërbimit.

Neni 4. Të Drejtat dhe Detyrimet e Përfituesit

- 4.1 Përfituesi pranon kryerjen e të gjitha Shërbimeve vetëm nga Ofruesi i Shërbimit.
- 4.2 Përfituesi do të bashkëpunojë me Ofruesin e Shërbimit kur rezultojnë e nevojshme për kryerjen e Shërbimeve, në bazë të kërkesës së këtij të fundit ose me iniciativën e vetë Përfituesit.
- 4.3 Përfituesi do t'i vendosë në dispozicion Ofruesit të Shërbimit mjetet e nevojshme dhe ambientin në Qendër për kryerjen sa më mirë të Shërbimeve sipas Marrëveshjes.
- 4.4 Përfituesi do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimit Tarifën e Shërbimeve Bazë sipas dispozitave përkatëse të Marrëveshjes.
- 4.5 Refuzimi i Përfituesit për të pranuar ndonjë nga Shërbimet nuk fshin detyrimin e tij për të paguar Tarifën e Shërbimit. Ky rregull zbatohet edhe në rastet kur Përfituesi nuk i përdor Shërbimet ose ka vazhduar të mos i përdorë ato, përveç rastit kur një mospërdorim i tillë ka ardhur për faj të Ofruesit të Shërbimit.
- 4.6 Përfituesi ka të drejtë të udhëzojë dhe të japë direktiva për Ofruesin e Shërbimit lidhur me përmbushjen e Shërbimeve dhe çështje të tjera të lidhura me to, të cilat mund të ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5. Të Drejtat dhe Detyrimet e Ofruesit të Shërbimit

- 5.1 Ofruesi i Shërbimit do të kryejë Shërbimet në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshje dhe kushtet e tjera të kësaj të fundit.

- 5.2 Ofruesi i Shërbimit do të kryejë Shërbimet, në një mënyrë tërësisht profesionale dhe kompetente, duke përdorur të gjitha kapacitetet e tij të burimeve njerëzore, me qëllimin e përbushjes së Shërbimeve duke respektuar të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje , duke plotësuar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kërkesat e Përfituesit.
- 5.3 Ofruesi i Shërbimit do të marrë parasysh dhe do të zbatojë kërkesat e Përfituesit në lidhje me të gjitha specifikat dhe kërkesat e kryerjes së shërbimeve të paraqitura nga kjo e fundit.

Neni 6. Kohëzgjatja dhe Përfundimi i Marrëveshjes

- 6.1 Kjo Marrëveshje do të lidhet për një afat prej 3 (tre) muajsh, duke filluar nga data e nënshkrimit. Palët mund të rinovojnë këtë Marrëveshje, pa kufizim, për të njëjtin afat kohor. Marrëveshja do të quhet e rinovuar me të njëjtat kushte nëse asnjëra nga palët nuk ka njoftuar tjetrën me shkrim për ndërprerjen e Marrëveshjes.
- 6.2 Secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër në formë të të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara për çfarëdo lloj arsye.
- 6.3 Përfundimi i marrëdhënieve kontraktuale që rrjedhin nga kjo Marrëveshje , për çfarëdo lloj arsye, nuk do të ndikojë në ndonjë të drejtë të fituar tashmë ose përgjegjësi të lindur të secilës Palë ose hyrjen në fuqi ose vazhdimin e efekteve të ndonjë prej parashikimeve të kësaj Marrëveshje , për të cilën është rënë dakord në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar që të jetë në fuqi gjatë ose pas përfundimit të saj.

Neni 7. Garanci

- 7.1 Ofruesi i Shërbimit garanton si më poshtë:
- 7.1.1 kryerjen e shërbimeve me kujdes të arsyeshëm, zotësi dhe cilësi;
- 7.1.2 kryerjen e shërbimeve në zbatim të kushteve dhe termave të kësaj Marrëveshje ;
- 7.1.3 mbrojtjen e dhe veprimin në interesin më të mirë të Përfituesit gjatë kryerjes së Shërbimeve;

Neni 8. Ruajtja e konfidencialitetit

- 8.1 Për të eliminuar çdo dyshim, i gjithë informacioni që Palët marrin nga kjo Marrëveshje dhe vetë Marrëveshja do të konsiderohet si sekret tregtar dhe duhet trajtuar ne përputhje me kërkesat për ruajtjen e fshehtësisë së tij.
- 8.2 Palët pajtohen që asnjë dokument, informacion, apo material, në dispozicion të tyre në kuadrin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk mund të bëhet i disponueshëm për palë të treta të paautorizuara.
- 8.3 Në rast se ndonjëra prej Palëve vlerëson se dhënia apo bërja publike e një informacioni kërkohet prej ligjit ose prej ndonjë autoriteti, informacioni do të jepet, për aq sa lejohet nga ligji dhe për aq sa është e mundur, pas aprovimit nga Palët tjetër.
- 8.4 Shkelja e detyrimit të konfidencialitetit nga Palët do të konsiderohet shkelje e rëndë kontraktuale dhe mund të rezultojë në prishje të menjëhershme të Marrëveshje s dhe shpërblim të dëmit të shkaktuar.

Neni 9. Forca Madhore

- 9.1 Asnjë nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë mospërbushje ose vonesë të përbushjes së detyrimeve kontraktore, që shkaktohen nga Forca Madhore si katastrofa natyrore, tërmete, luftëra, akte sabotimi, greva, kryengritja, trazira si dhe ndalime ose kufizime ligjore ose nxjerrja e akteve nënligjore të cilat pengojnë ose kufizojnë përbushjen e detyrimeve dhe të drejtave që

rrjedhin nga kjo Marrëveshje në një nivel të konsiderueshëm si dhe defekte teknike të rënda ose ndërprerje të përgjithshme të energjisë elektrike.

- 9.2 Vonesat në përmbushjen e detyrimeve ose mospërmbushje të tyre nga ana e njëjës palë nuk e legjitimojnë palën tjetër të përfundojë marrëdhënien kontraktuale nëse një mospërmbushje e tillë ka ardhur si rezultat i shkaqeve të përcaktuara në pikën 9.1 të kësaj Marrëveshje .

Neni 10. Përgjegjshmëria

- 10.1 Ofruesi i Shërbimit garanton përmbushjen dhe kryerjen e Shërbimeve në afatin e duhur dhe në një mënyrë të kujdesshme dhe kompetente në bazë të rregullave dhe standardeve të praktikave më të mira të pranuar.
- 10.2 Ofruesi i Shërbimit është përgjegjës për ndonjë mospërmbushje në kohë të Shërbimeve, për një mospërmbushje të tillë ai duhet të paguajë një penalitet prej 2% të Tarifës së Shërbimit për çdo ditë vonesë.

Neni 11. Komunikimi

- 11.1 Kur njëra nga palët e kësaj Marrëveshje detyrohet ose është e legjitimuar të njoftojë ose drejtojë tek pala tjetër, ose të paraqesë një kërkesë ose lutje, këto të fundit duhet të paraqiten në formë të shkruar dhe do të konsiderohen se janë dorëzuar nëse dërgohen dorazi tek personi tek i cili janë drejtuar ose nëse dërgohen nëpërmjet rrugës elektronike (e-mail) tek pala së cilës i referohen në adresën e mëposhtme ose atë të ndryshuar përkatësisht, duke marrë të mirëqenë se një ndryshim i tillë i është njoftuar palës tjetër në mënyrat e përcaktuara në këtë nen. Komunikimet do të adresohen si më poshtë:

Ofruesi i Shërbimit:

Në vëmendje të:

Nr. Tel:

E-mail:

Teatri i Kukullave Tiranë

Përfituesi:

Adresa:

Në vëmendje të:

E-mail:

Tirana East Gate Sh.p.k

Qendra Tregtare TEG, Rruga Nacionale Tiranë – Elbasan,

Farkë, Lundër, Tiranë

Znj. Milena Gjoni

m.gjoni@acrem.al

Neni 12. Dispozita Përfundimtare

- 12.1 Marrëveshja zëvendëson çdo lloj korrespondence të mëparshme të mbajtur midis palëve kontraktuese. Kjo Marrëveshje mbizotëron mbi çdo term ose detyrim tjetër ose ndonjë dokument tjetër që është pranuar nga palët kontraktuese.
- 12.2 Marrëveshjet jo-formale janë të vlefshme vetëm nëse materializohen në formë të shkruar. Ky rregull duhet të ndiqet edhe në rastin e ndryshimeve ose modifikimeve pasuese të cilat nuk janë miratuar nga përfaqësuesit ligjorë ose nga persona të legjitimuar të përfaqësojnë palën përkatëse kontraktuese.
- 12.3 Mosekzekutimi i ndonjë të drejtë të rrjedhur nga Marrëveshja nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga kjo e fundit.
- 12.4 Në rast se ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes ose pjesë e saj është ose shpallet e pavlefshme, nuk do të çenohet vlefshmëria e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet

nga një dispozitë e vlefshme, e cila duhet të ketë një kuptim dhe qëllim të njëjtë ose të përafërt me atë të dispozitës së pavlefshme.

Neni 13. Ligji i Zbatueshëm. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve.

- 13.1 Kjo marrëveshje zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 13.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata Kompetente Shqiptare. Me kusht që të jetë ligjërisht e lejuar, zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve do të kryhet në Tiranë.
- 13.3 Termat dhe kushtet e përcaktuara këtu përbëjnë marrëveshjen e plotë midis palëve dhe mund të ndryshohen ose shtohen vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje.

Neni 14. Gjuha

- 14.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga secila prej palëve dhe përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë secila, nga një për secilën palë.

LEXUAR, PRANUAR, NËNSHKRUAR NGA:

PALET

PËRFITUESI:

MSLEMA GJONI

(Përfaqësues ligjor)



OFRUESIT TË SHËRBIMIT

Oliver Sani

(Përfaqësues ligjor)

